

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6189  
E shtunë, 12 dhjetor 2020  
çmimi 0.40 €

ËSHTË THEMELUAR FONDACIONI “PËRKRAHJE PËR MBROJTJEN JURIDIKE TË HASHIM THAÇIT”  
ME QËLLIM TË MBËSHTETJES JURIDIKE PËR ISH-PRESIDENTIN THAÇI NDAJ TË CILIT ËSHTË  
NGREHUR AKTAKUZË NË PROCESIN GJYQËSOR PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

## THEMELOHET FONDACIONI PËR PËRKRAHJEN DHE MBROJTJEN JURIDIKE TË THAÇIT



Për përkrahjen e mbrojtjes juridike të ish-presidentit Thaçi tashmë është themeluar Fondacioni “Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçit”. Ky fondacion, i themeluar mbi bazën e ligjeve në fuqi, ka për qëllim mbështetjen e mbrojtjes juridike të ish-presidentit Thaçi, duke siguruar mbështetje financiare për të mundësuar mbrojtje të mirëfilltë, asistencë teknike dhe profesionale për ekipin e mbrojtjes në kuadër të këtij procesi gjyqësor, si dhe bashkëpunim me të gjitha instancat e interesuara me qëllim të avancimit të së vërtetës dhe të historisë së luftës për liri të ish-presidentit Thaçi dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Fondacioni është themeluar me iniciativën e Idriz Thaçit, vëllait të ish-presidentit Thaçi

## VITET E FUNDIT PRAKTIKAT E INTEGRITETIT TË POLICISË KANË HASUR NË SFIDA

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar raportin “Gjendja aktuale e integritetit në Policinë e Kosovës”. Sipas këtij rapporti, mosmiratimi i Ligjit për pensionim të parakohshëm për zyrtarët policorë dhe Ligjit për trajtimin e invaliditetit vazhdon

ta sfidojë efektivitetin e Policisë së Kosovës. Ndërkaj plani aktual i Integritetit të Policisë së Kosovës është i vjetruar dhe ende nuk është miratuar plani i ri. Në report theksohen se sfidat serioze mbesin edhe në menaxhimin e burimeve njerëzore, gjegjësisht Policia e



Kosovës përballet me shpërndarje joadekuante të gradave në departamentet e veta dhe disa departamente përballen me mungesa për plotësimin e pozitave me gradat adekuante

Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



## AKTUALE



MBI 11 900 RASTE AKTIVE ME  
COVID NË KOSOVË F. 7

KOSOVA DHE SHQIPËRIA BËHEN  
BASHKË PËR PARANDALIMIN E  
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM  
DHE TERRORIZMIT F. 6

OBILIQI NDAN 100 EURO PËR  
ÇDO TË INFETUAR ME COVID  
DHE NGA 300 EURO PËR  
FAMILJET E VIKTIMAVE F. 10

## EKONOMI

PËRFITIMET E GURËTHYESVE  
NGA QEVERIA F. 8

KOMISIONIT PËR  
HIDROCENTRALE  
I VAZHDOHET MANDATI F. 8



## SPORT

DERBI NË SUHAREKË F. 12



**RENOVA**  
PUTZ  
Makedoni Xhepcisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289  
E-mail: renova@mt.net.mk

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.  
DEGA KOSOVO  
Ruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...

## Bideni dhe Harris i shpallen Persona të Vitit nga revista "Time"

**UASHINGTON, 11 DHJETOR** - Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, dhe zëvendësja e tij, Kamala Harris, janë zgjedhur Persona të Vitit nga revista amerikane "Time". "Zgjedhja Biden-Harris përfaqëson diçka historike", ka shkruar "Time" në faqen zyrtare në "Twitter". Dyshja demokratike mundi tre finalistë të tjera: punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe mjeku

Anthony Fauci, lëvizjen për drejtësi racore dhe presidentin aktual të ShBA-së, Donald Trump, i cili humbi garën kundrejt Bidenit.

"Time" zgjedh personin më me ndikim të vitit qysh më 1927.

"Për ndryshimin e historisë amerikane, për dëshminë e forcave të ndjeshmërisë janë më të mëdha se furtë e përcarjes, për ndarjen e një vizioni të shërimit në një botë

të pikëlluar, Joe Biden dhe Kamala Harris janë Persona të Vitit 2020 të revistës "Time", ka thënë kryeredaktori i saj, Edward Felsenthal.

Në vitin 2016, Trump, atëbotë po ashtu president i zgjedhur, mori të njëjtën njohje nga revista. "Time" zgjedh çdo vit një person, një grup, një ide ose një objekt që "për të mirë ose për të keq" ka pasur ndikimin më të madh në ngjarjet e atyre 12 muajve.



## BE-ja planifikon të vendosë sanksione të reja ndaj Turqisë

**BRUKSEL, 11 DHJETOR** - Liderët e Bashkimit Evropian kanë vendosur të prenten që të krijojnë një listë me sanksione në kundërpërgjigje ndaj veprimeve të Turqisë që ka kryer eksplorime për gaz në ujërat e Greqisë dhe Qipros. "Turqia është angazhuar në veprime të njëanshme dhe provokime dhe ka përvallëzuar retorikën e saj ndaj BE-së, shteteve anëtare të BE-së dhe liderëve evropianë. Veprimet e njëanshme dhe provokimet në Mesdheun Lindor ende po vazhdojnë, përfshirë edhe në zonën ekonomike të Qipros", është thënë në deklaratën e publikuar pas debatit të liderëve të BE-së në samitin që po mbahet në Bruksel. Një diplomat ka thënë për



agjencinë "AFP" se sanksionet do të kenë në shënjestë individë dhe se blloku evropian do të ndërmarrë edhe masa të tjera, "nëse Turqia vazhdon me veprimet e saj".

Ministria e Jashtme turke ka thënë se kjo listë e re e

sanksioneve nga BE-ja është "e njëanshme" dhe "e paligjshme".

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka mirëpritur vendimin e BE-së mbi Turqinë, duke thënë se do të kishte zhgënjim në Greqi

dhe Qipro nëse liderët evropianë nuk do të pajtohen për një embargo të armëve apo për sanksionim të sektorëve të ekonomisë turke. Ndërsa kancelarja gjermane Angela Merkel ka thënë se shpreson se mesazhi i dërguar nga BE-ja "do të pranohet në mënyrën e duhur". Konkluzionet, që janë publikuar nga Këshilli Evropian, tregojnë se lista do të përpilohet për sanksionet ndaj Turqisë. Liderët e kanë mandatuar shefin për politikë të jashtme të BE-së, Josep Borrell, që të përgatisë një raport me më shumë masa ndaj Turqisë, i cili duhet të dorëzohet marsin e ardhshëm. Para këtij samiti, presidenti turk, Rexhep Taip Erdogan, ka thënë se "Turqia nuk

shqetësohet për sanksionet që do të ndërmerrin nga BE-ja". "BE-ja asnjëherë nuk na ka trajtar me ndershmëri. BE-ja nuk ka mbajtur premtimin që na ka dhënë, por ne gjithmonë kemi qenë të durueshëm dhe ende jemi", ka deklaruar Erdogan.

Greqia, me mbështetjen e Francës, ka qenë ajo që ka iniciuar vendosjen e sanksioneve më të ashpra ndaj Ankarasë, pasi Turqia vazhdimisht kryen eksplorime për gaz në ujërat e kontestuar. Përveç eksplorimeve të kryera në Mesdhe, Turqia, po ashtu, është akuzuar se ka shkelur embargon e armëve të Kombeve të Bashkuara për Libinë, shtet ku Ankaraja mbështet qeverinë në Tripoli në luftën civile.

## Bill Gates dhuron 250 milionë dollarë për vaksinën kundër Covidit

**UASHINGTON, 11 DHJETOR** - Bill Gates ka paralajmëruar përgatitje ndaj pandemisë që mund të zgjasë me vite dhe ai nuk ka vendosur të rrijë duarkryq. "Kjo do të ngulitet në kujtesën e kësaj gjenerate, shpresojmë mjaftueshëm, që të investojmë dhe të jemi të gatshëm për herën tjetër. Mbajmë shpresën që të investojmë më shumë në këto

sëmundje infektive që ende janë problem shumë i madh", ka thënë Gates për "ABC News". Fondacioni Bill dhe Melinda Gates ka njoftuar se një donacion i ri prej 250 milionë dollarësh që është bërë e ka çuar në 1.7 miliard investimin total kundër Covid-19 për krijimin e vaksinës dhe shpërndarjes së saj. "Po bie në vend plani që të nxirret

vaksina. Andaj, është tragjedi, por ka shumë heronj rrugës e sipër që po i japin fund", ka thënë Gates.

Gates, i cili kishte investuar në teknologjinë e vaksinave më 2015, ka theksuar rëndësinë e vaksinave lajmëtare (RNA/mRNA) të cilat mund t'i japin fund pandemisë dhe ndonjë pandemie tjetër që mund të vijë.



## Franca, orë policore nga 15 dhjetori

**Paris, 11 dhjetor** - Franca do ta shtyjë rihapjen e lokacioneve kulturore dhe do të vendosë orë policore për ta frenuar përhapjen e koronavirusit. Kryeministri Jean Castex ka thënë se normat e infektimit nuk janë duke rënë me

ritmin që ka shpresuar qeveria, pas vendosjes së masave të izolimit në fund të tetorit. Urdhri përqëndrim nështëpi do të hiqet më 15 dhjetor, kur edhe do të nisë ora policore nga ora 20:00 deri në 06:00. Masa nuk do të

hiqet për Vtin e Ri, për t'i parandaluar tubimet e mëdha. Qeveria e ka kushtëzuar lehtësimin e masave me rënien e numrit të të infektuarve në rreth 5 000 në ditë. Por, ky numër ka qenë shumë më i lartë se 10 000

të enjten, përkatësisht 13 750. "Nuk jemi ende në fund të kësaj vale të dytë dhe nuk do t'i arrjmë objektivat e vëna për 15 dhjetor", ka thënë kryeministri Castex në një konferencë për media. "Duhet të mbetemi të

përqendruar dhe ta gjejmë rrugën gjatë javëve të ardhshme", ka thënë ai. Muzetë, kinematë, teatrot dhe vendet sportive, që pritej të rihapseshin të martën, do të qëndrojnë të myllura edhe pëtri javë.

# Vitet e fundit praktikat e integritetit të policisë kanë hasur në sfida

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar reportin "Gjendja aktuale e integritetit në Policinë e Kosovës". Sipas këtij rapporti, mosmiratimi i Ligjit për pensionim të parakohshëm për zyrtarët policorë dhe Ligjit për trajtimin e invaliditetit vazhdon ta sfidojë efektivitetin e Policisë së Kosovës. Ndërkaq plani aktual i Integritetit të Policisë së Kosovës është i vjetruar dhe ende nuk është miratuar plani i ri. Në raport theksohet se sfidat serioze mbesin edhe në menaxhimin e burimeve njerëzore, gjegjësisht Policia e Kosovës përballet me shpërndarje joadekuante të gradave në departamentet e veta dhe disa departamente përballen me mungesa për plotësimin e pozitave me gradat adekuate

**EPOKA  
ERE** Faton DËRMAKU

**PRISEHINË, 11 DHJETOR** - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar reportin "Gjendja aktuale e integritetit në Policinë e Kosovës". Sipas këtij rapporti, vitet e fundit praktikat e integritetit të Policisë së Kosovës kanë hasur në sfida të ndryshme marrë parasysh edhe situatën e rënduar me pandeminë Covid-19. "Zyrtarë të shumtë policorë u janë nënshtuar hetimeve penale nga mekanizmat përkatës të sundimit të ligjit për vepra të pretenduara penale në lidhje me shkelje të procedurave ligjore që rregullojnë detyrat e tyre zyrtare. Në anën tjetër, një zhvillim tjetër i papritur

ishte vendimi i kryeministrat të Kosovës i marrë në tetor 2020 për shkarkimin e ish-drejtitor të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që i ka hapur rrugën ndikimit të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë politik nga partitë në pushtet mbi Policinë e Kosovës. Për më tepër, kjo mund të ketë ndikim të dukshëm në dekurajimin e reformave strukturore në polici, veçanërisht në menaxhimin e burimeve njerëzore", theksohet në raport.

Raporti i QKSS-së analizon legjislacionin në fushën e integritetit policor, ndërsa si sfida kyçe mbesin miratimi i legjislacionit shtesë për sinjalizim dhe ndryshimi i Ligjit për deklarimin e pasurisë që ende nuk

janë miratuar. "Mungesa e vullnetit politik, e shoqëruar edhe nga kriza e vazhdueshme politike, ka pasur ndikim të rëndësishëm negativ në këtë drejtim. Po ashtu, nuk dihet ende nëse policia ka miratuar apo jo Rregulloren për Integritet. Mosmiratimi i Ligjit për pensionim të parakohshëm për zyrtarët policorë dhe Ligjit për trajtimin e invaliditetit vazhdon ta sfidojë efektivitetin e Policisë së Kosovës. Ndërkaq, plani aktual i Integritetit të Policisë së Kosovës është i vjetruar dhe ende nuk është miratuar plani i ri. Për më tepër, efektet e këtij dokumenti strategjik të policisë janë minimizuar edhe nga mospërfshirja e mekanizmave të jashtëm të mbikëqyrjes së Policisë

së Kosovës në hartimin e tij, marrë parasysh rolin që luajnë mekanizmat e tillë në mbikëqyrjen e çështjeve për integritetin në Policinë e Kosovës", është thënë në këtë raport.

Raporti ka analizuar mekanizmat e brendshëm të policisë për ngritjen e integritetit. Në këtë drejtim, mekanizmat e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës kanë identifikuar një numër të lartë të ankesave të pabazuara të parashtruara në këto mekanizma gjatë vitit 2019. "Për pasojë, gjasat janë të mëdha të ketë pasiguri në lidhje me procedurat e raportimit dhe përpunimit të ankesave, qoftë nga qytetarët ose nga vetë zyrtarët policorë. Sfidat serioze mbesin edhe në menaxhimin e burimeve njerëzore, gjegjësisht Policia e Kosovës përballet me shpërndarje joadekuante të gradave në departamentet e veta dhe disa departamente përballen me mungesa në plotësimin e pozitave me gradat adekuate, ndërsa departamente të tjera e kanë tejkaluar numrin e gradave të parapara në disa pozita.

Sa i përket menaxhimit finansiar, Policia e Kosovës e ka përmirësuar ekzekutimin e buxhetit të vet në vitin 2020. Sidoqoftë, shumica e

kontratave për shpenzime kapitale në vitet 2019-2020, të cilat më parë ishin burim i sfidave në ekzekutimin e buxhetit, janë dokumente të klasifikuara dhe si të tilla nuk janë audituar. Kjo tregon prirjen për klasifikim të tepruar të kontratave të prokurimit, duke krijuar kështu hapësirë për keqpërdorime të mundshme të ciklit të prokurimit", theksohet në raportin e QKSS-së.

Përmes këtij rapporti, QKSS-ja ka nxjerrë disa rekomandime konkrete për Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera që e mbikëqyrin këtë institucion me qëllim ngritjen e integritetit policor dhe profesionalizimin e policisë.

Një ndër rekomandimet është miratimi i legjislacionit plotësues në fushën e luftimit të korruptionit dhe integritetit në polici, si dhe policia të jetë gjithëpërfshirësa sa i takon hartimit të planit të ri të integritetit dhe zbatimit të tij në praktikë. Konferanca dhe raporti i publikuar nga QKSS është në kuadër të projektit "Fuqizimi i integritetit në Policinë e Kosovës" me mbështetje të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).





ËSHTË THEMELUAR FONDACIONI “PËRKRAHJE PËR MBROJTJEN JURIDIKE TË HASHIM THAÇIT” ME QËLLIM TË MBËSHTETJES JURIDIKE PËR ISH-PRESIDENTIN THAÇI NDAJ TË CILIT ËSHTË NGREHUR AKTAKUZË NË PROCESIN GJYQËSOR PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

# THEMELOHET FONDACIONI PËR PËRKRAHJEN DHE MBROJTJEN JURIDIKE TË THAÇIT

Për përkrahjen e mbrojtjes juridike të ish-presidentit Thaçi tashmë është themeluar Fondacioni “Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçit”. Ky fondacion, i themeluar mbi bazën e ligjeve në fuqi, ka për qëllim mbështetjen e mbrojtjes juridike të ish-presidentit Thaçi, duke siguruar mbështetje financiare për të mundësuar mbrojtje të mirëfilltë, asistencë teknike dhe profesionale për ekipin e mbrojtjes në kuadër të këtij procesi gjyqësor, si dhe bashkëpunim me të gjitha instancat e interesuara me qëllim të avancimit të së vërtetës dhe të historisë së luftës përliri të ish-presidentit Thaçi dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Fondacioni është themeluar me iniciativën e Idriz Thaçit, vëllait të ish-presidentit Thaçi

**EPOKA  
ERE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 11 DHJETOR** - Për përkrahjen e mbrojtjes juridike të ish-presidentit Hashim Thaçi tashmë është themeluar Fondacioni “Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçit”. Ky fondacion i themeluar mbi bazën e ligjeve në fuqi ka për qëllim mbështetjen e mbrojtjes juridike të ish-presidentit Thaçi, vëllait të ish-presidentit Thaçi.

Duke siguruar mbështetje financiare për të mundësuar mbrojtje të mirëfilltë, asistencë teknike dhe profesionale për ekipin e mbrojtjes në kuadër të këtij procesi gjyqësor në Hagë. “Duke qenë plotësisht të vetëdijshëm përliri të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe duke kujtuar sakrificën e popullit tonë përballet regjimit serb që kreuz krimet gjenocidale ndaj popullatës civile në Kosovë

gjatë viteve 1998-1999; duke nderuar dëshmorët e rënë përliri dhe duke kujtuar të gjitha viktimat civile të shkaktuara nga regjimi serb gjatë luftës përlirim, si dhe duke besuar plotësisht në pafajësinë e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndaj akuzave për krimet luftës; mbi të gjitha, duke qëndruar të palëkundur përliri të vërtetës e historisë sonë, përmes kësaj komunikate, ju njoftojmë se është themeluar Fondacioni ‘Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçit’ me qëllim të mbështetjes juridike përliri të presidentit Thaçi, ndaj të cilit është ngritur aktakuzë në procesin gjyqësor pranë Dhomave të Specializuara”, ka njoftuar Fonacioni Përkrahje përliri mbrojtjen juridike të Hashim Thaçit.

Sipas këtij njoftimi, ky fondacion është themeluar me iniciativë të vëllait të ish-presidentit Thaçi, Njaziut. “Fondacioni është themeluar mbi bazën e ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe ka për qëllim që ta mbështesë mbrojtjen juridike të presidentit Thaçi. Disa nga aktivitetet themelore të Fondacionit janë si në vijim:

Organizimi i ligjshëm dhe transparent për ngritjen e fondeve dhe sigurimi i mbështetjes financiare përliri të mundësuar mbrojtje të mirëfilltë juridike përliri të zhvillimit të procesit gjyqësor ndaj tij; ofrimi i asistencës teknike dhe profesionale përliri ekipin e mbrojtjes në kuadër të këtij procesi gjyqësor, me qëllim të argumentimit të pafajësisë së presidentit Thaçi përballet pretendimeve të aktakuzës kundër tij; bashkëpunimi me të gjitha instancat e interesuara me qëllim të avancimit të së vërtetës dhe të historisë së luftës përliri të presidentit Thaçi dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Fondacioni është themeluar me iniciativën e z. Idriz Thaçi, vëllait të ish-presidentit Thaçi. Fondacioni do ta ketë Bordin, i cili ushtron përgjegjësinë e mbikëqyrjes së funksionimit të Fondacionit, si dhe stafin menaxhues që do ti bartë detyrat që lidhen me qëllimet dhe aktivitetet e Fondacionit”, ka njoftuar fonacioni në fjalë. Më tutje, është bërë me dije se në ditët në vijim bordi i fondacionit do t'i drejtohet opinionit publik ku do të prezantojë më hollësish

planet dhe priorititet e fondacionit. “Fondacioni do të shërbejë si adresë e vetme përlirim e lartekura dhe do të integrojë çdo ndihmë financiare përlirim e mbrojtjes juridike të presidentit Thaçi, në mënyrë legale, transparente dhe profesionale. Më poshtë po publikojmë edhe llogaritë bankare të Fondacionit, të cilat do të jenë adresat e vetme përlirim e fondeve përlirim e lartekura. Titullari i llogarisë: PMJHTh-Përkrahje përliri mbrojtjen Juridike të Hashim Thaçit SWIFT CODE: EKOMXKPRXXX. Nr. Llogarisë: 1401000001722802. IBAN: XK051401000001722802. Titullari i llogarisë: Përkrahje përliri mbrojtjen Juridike të Hashim Thaçit. SWIFT CODE: CDISALTRXXX. Nr. Llogarisë: 00001456235. IBAN: AL4021211573000000001456235”, ka njoftuar Fonacioni “Përkrahje përliri mbrojtjen juridike të Hashim Thaçit”. Në Hagë, përpos Thaçit, gjenden edhe ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli e Jakup Krasniqi, shefi i grupit parlamentar i Vetëvendosjes, Rexhep Selimi, dy drejtuesit e OVLUÇK-së, Hysni Gucati e Nasim Haradinaj dhe Salih Mustafa.

# KDI-ja: Kuletat e subjekteve politike parlamentare, me shumë borxhe e pak donacione

Prishtinë, 11 dhjetor (ER) - Përfaqësues të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) kanë mbajtur të premten konferencë për media, ku është shpalosur hulumtimi "Kuletat e subjekteve politike parlamentare: Si qëndrojnë financiarisht ato?"

Ky hulumtim paraqet një analizë të raporteve vjetore financiare të subjekteve politike parlamentare në Kosovë për vitin 2019, të cilat janë publikuar në version të paudituar, në fund të titorit të këtij viti.

Eugen Cakoli nga KDI-ja theksuar se mospublikimi në kohë i raporteve vjetore financiare të subjekteve politike paraqet mungesë të theksuar të transparencës dhe llogaridhënie së tyre ndaj

publikut.

Ai ka thënë që në periudhën 2013-2017 Kuvendi kishte dështuar të përgjedhë auditorë të jashtëm, duke pamundësuar publikimin e raporteve vjetore financiare. Madje raportet e vitit 2018 nuk janë publikuar ende në faqen zyrtare të KQZ-së.

Raporti nënvízon që subjektet politike parlamentare zotërojnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në vlerë të përgjithshme mbi 420 mijë euro. Megjithatë, sipas tij, subjektet politike parlamentare nuk qëndrojnë mirë me borxhet, me mbi 2 milionë euro detyrime të deklaruara.

Vetëm PDK-ja dhe LDK-ja kanë deklaruar mbi 1,1 milion euro detyrime apo gati 2/3 e detyrimeve të përgjithshme të të

gjitha subjekteve politike parlamentare në Kosovë.

Në përgjithësi, subjekti politike kanë deklaruar bilanc negativ financiar, me afro një milion euro më shumë shpenzime se të hyra të deklaruara.

Ky fenomen është vazhdimesi e trendëve paraprakë edhe të vitit 2017, kur në përgjithësi ishin deklaruar mbi 2 milionë euro shpenzime më tepër sesa të hyra.

Sa iu përket shpenzimeve, subjekti politike parlamentare pjesën më të madhe të shpenzimeve të vitit 2019 i kanë deklaruar përfundatë dhe paga, përkatesisht 2.1 milionë euro në fushatë dhe 1.3 milion euro në paga dhe kompensime. Megjithatë, ekziston shpërputhje midis shpenzimeve

që subjekti politike i kanë deklaruar përfundatë dhe raporteve që Demokracia në Veprim ka publikuar përfundimet e partive gjatë fushatës.

Sipas vlerësimit të Demokracisë në Veprim, vetëm në kuadër të aktivitetave publike të monitoruara janë shpenzuar 3 milionë e 636 mijë euro, apo rreth 1 milion e gjysmë euro më shumë sesa deklarimet e subjekteve politike.

Në anën tjeter, edhe pse donacionet shihen si një nga burimet kryesore të financimit, sidomos gjatë viteve zgjedhore, subjekti kanë deklaruar vetëm 214 mijë euro donacione, që përbën vetëm 4.6 përfundatë të hyrave të përgjithshme të tyre. Cakoli vuri theksin që edhe

subjekti i dytë në zgjedhje, aktualisht udhëheqës i koalicionit qeverisës, LDK-ja, përgjatë tërë vitit 2019 ka deklaruar se ka pranuar vetëm një donacion në vlerë vetëm 38.54 euro. AKR-ja është subjekti që prin me donacione, pasuar nga LV-ja dhe Alternativa. Në bazë të raporteve, vërehet se pjesa më e madhe e donacioneve që kanë pranuar subjekti politike kanë ardhur nga anëtarë të tyre, në vlera prej 10 deri në 1 000 eurosh. Në fund u theksua që pesë subjekte politike, përfshirë LV-në, LDK-në, AAK-në, LS-në dhe PAI-n, nuk kanë përmblushur përcaktimet ligjore lidhur me pasqyrat bankare, duke mos i përfshirë të njëjtat në raporte vjetore.



## Osmani pranoi letrat kredenciale të ambasadores së Maqedonisë së Veriut

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, ka pranuar të premten letrat kredenciale të ambasadores së Maqedonisë së Veriut, Shpresa Jusufi. Në takim, u. d. presidentja Osmani vlerësoi se bashkëpunimi ndërmjet të dy shteteve, bazohet edhe në afersinë gjeografike dhe lidhjet

njerëzore ndërfqinjësore. Sipas saj, stabiliteti rajonal dhe proceset integruese janë faktorë të rëndësishëm përfundatë për paqen rajonale, por edhe përfundatë e procesin euro-atlantik.

Të dy bashkëbisedueset u pajtuan se bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut është i shkëlqyeshëm dhe se synohet thellimi i mëtejmi.



# Kosova dhe Luksemburgu diskutojnë për reformat kryesore zhvillimore në takimin dypalësh vjetor

EPOKA  
ERE


Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 11 DHJETOR** - Zyra e Kryeministrat e Republikës së Kosovës dhe Ambasada e Luksemburgut në Kosovë organizuan takimin vjetor të Komisionit të Partneritetit ndërmjet Kosovës dhe Luksemburgut. Takimi u mbajt virtualisht përmes platformave elektronike. Gjatë takimit delegacionet diskutuan në lidhje me progresin dhe sfidat për realizimin e ndihmës së Luksemburgut në Kosovë në fushat e shëndetësisë, arsimit dhe aftësimit profesional, si dhe të integrimit në BE, në kuadër të marrëveshjes dypalëshe 2017-2020.

Palët u pajtuan që memorandumi aktual i mirëkuptimit ndërmjet dy vendeve të zgjatet deri në dhjetor të vitit 2021. Në hapje të takimit, kreu i delegacionit të Kosovës, Florim Canolli, drejtor i Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim, ka theksuar nevojën e fuqizimit të pronësisë së

mbështetjes së donatorëve, si dhe të përcaktimit të pritjeve të përbashkëta me partnerët zhvillimorë. "Luksemburgu ka vazduar ta mbështesë Kosovën në shumë fusha jetike, ndërsa kohën e fundit ka qenë veçanërisht mbështetës në sektorin e shëndetësisë. Kosova është në proces të krijuar të agjendës afatgjatë të zhvillimit, Agjendës Kombëtare të Zhvillimit, e cila do ta formulojë vizionin për dekadën e ardhshme dhe ne do të bashkëpunojmë ngushtë me partnerët zhvillimorë për ta mbështetur rrugën e Kosovës drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe integrimit në BE", ka thënë Canolli.

Kreu i delegacionit të Luksemburgut, Christophe Schiltz, koordinator i Përgjithshëm i Bashkëpunimit për Zhvillim dhe i Çështjeve Humanitare në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Luksemburgut, ka theksuar se Luksemburgu është i përkushtuar ndaj partneritetit të tij me



Kosovën, kur bëhet fjalë për bashkëpunimin dypalësh për zhvillim, duke përfshirë luftën kundër pandemisë aktuale Covid-19. "Në vitin 2021 Luksemburgu po planifikon një rishikim të brendshëm të mundshëm të bashkëpunimit të tij zhvillimor me Kosovën, i cili do të na mundësojë ta shqyrtojmë

ndikimin që kanë pasur programet tona të deritanishme, ta vlerësojmë qëndrueshmërinë e tyre, si dhe t'i orientojmë marrëdhëniet tona të ardhshme me Kosovën", ka thënë ai. Gjatë Komisionit të Partneritetit u bë një përparim i konsiderueshëm në lidhje me vazhdimin e projekteve

dypalëshe aktuale të zhvillimit në tri fushat strategjike të bashkëpunimit, veçanërisht në sektorët e shëndetësisë dhe të arsimit, si dhe në rrugën e Kosovës drejt integrimit evropian. Komisioni i ardhshëm i partneritetit ndërmjet Luksemburgut dhe Kosovës do të zhvillohet në vitin 2021.

## Kosova dhe Shqipëria bëhen bashkë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit

**PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER)** - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme të premtën është mbajtur takimi në të mes përfaqësuesve të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga Lulzim Fushtica, këshilltar i ministrit të Punëve të Brendshme dhe delegacionit nga Republika e Shqipërisë, i udhëhequr nga drejtoresha e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm,



pranë Zyrës së Kryeministrat, Lejdi Dervishi. Në këtë takim u diskutua për

metodat që janë duke përdorur të dy shtetet sa i përket ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit për

mundësitet e koordinimit të veprimeve të të dy vendeve për parandalimin e këtij fenomeni. Me theks të veçantë u diskutua për deradikalizmin e personave të radikalizuar, qasjen që janë duke përdorur të dy vendet, përkthimin në jetën normale të këtyre personave dhe risocializimin e tyre, si një ndër metodat esenciale përkthimin e tyre në normalitet. Të dy delegacionet u pajtuan që t'i ndajnë përvojat e përbashkëta,

duke marrë përbazë format që kanë përdorur vendet e ndryshme të botës, me qëllim të krijuar të një partneriteti, ku aty ku ka nevojë të dy shtetet të mbështesin njëra-tjeter. Në fund të takimit të dy delegacionet shprehën nevojën e takimeve dhe komunikimin e vazdueshëm, në mënyrë që dy vendet të trajtojnë me qasjen e duhur këtë dukuri shumë komplekse.

## Kërkohet lejimi i shkollimit të vajzave që bartin mbulesë në Kosovë

**PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER)** - Anëtarët e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Petitione, e kanë quajtur diskriminuese përashtimin nga shkollat të vajzave që bartin mbulesë. I ftuar ishte ministri i Arsimit dhe Shkencës (MASH), Ramë Likaj, nga i cili është kërkuar që të hiqet udhëzimi administrativ që ndalon bartjen e mbulesës në shkolla.

Kryetarja e këtij komisioni, Duda Balje, ka thënë se ministri i Arsimit ka kompetencë për të lejuar vajzat që bartin mbulesën në shkolla. Ndërsa anëtarja e po këtij komisioni, Besa Ismaili, ka pyetur ministrin Likaj se në bazë të cilit ligji po u ndalohet vajzave me

shami shkollimi. Ajo, po ashtu, ka thënë se edhe brenda Ministrisë së Arsimit ka lajthitje për këtë çështje. "Brenda Ministrisë së Arsimit ka lajthitje sa iu përket politikave thotë Ismajli. Përfaqësuesi ligjor i MASH-it e mohon se udhëzimi administrativ flet për shaminë. Ne kemi të drejtë të dimë cili është pozicioni juridik që ka marrë kjo ministri. Këto vajza që nuk kanë shkuar në shkollë e ka pasur ministria ndonjë program tjetër t'u ofrojë ndonjë arsimin ndryshe?", ka pyetur Ismaili.

Ndërsa ministri Likaj ka thënë se Kosova është shtet laik. Ai thotë se për çështjen e bartjes së mbulesës në shkolla ka kërkuar interpretim edhe nga



Avokati i Popullit. "Unë kam kërkuar edhe mendim të Zyrës së Avokatit të Popullit. Unë vetë jam besimtar, por s'e praktikoj, por urdhëresa administrative e ministrit është bazuar në Ligjin

për Arsimin Profesional", ka thënë Limaj. Sipas Likajt, liria e festimit të fesë mund të kufizohet me ligj sipas interpretimit të Avokatit të Popullit. "Bazuar në Gjykatën

Kushtetuese si dhe bazuar në Gjykatën Evropiane, kufizimi i lirisë fetare për bartjen e shamisë bëhet me qëllim të pajtimit të interesave të ndryshme, ku bartja e shamisë mund të ketë efekt përimponimin e saj", ka cituar Likaj interpretimin e Avokatit të Popullit.

Më tutje, deputetja Saranda Bogujević ka thënë se nuk është duke kuptuar kodin e mirësjelljes sa i përket mbulesës. Kurse deputetja Teuta Haxhiu i ka thënë ministrit Likaj se ka bërë shkelje. "E drejta e secilit është për t'u arsimuar në këtë vend. Më mirë të kemi këto vajza në shkolla sesa në Siri", ka thënë Haxhiu.

Në 24 orët e fundit: 13 të vdekur dhe 590 raste të reja me Covid në Kosovë

## Mbi 11 900 raste aktive me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të premten edhe për 590 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 1 775 mostrave. Sipas Institutit, brenda 24 orëve kanë vdekur edhe 13 pacientë të infektuar me Covid. Po ashtu, gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 696 pacientë. Ndërkaq numri i rasteve aktive me Covid-19 në vendin tonë është 11 922

**EPOKA ERE** Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 11 DHJETOR** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar 1 775 gjithsej mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 590 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar 13 raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Ferizaj tri raste (83, 59, 54 vjeç), Pejë dy raste (77, 72 vjeç), Prizren dy raste (89, 81 vjeç), Viti një rast (78 vjeç), Podujevë një rast (76 vjeç), Suharekë një rast (81 vjeç), Drenas një rast (88 vjeç), Gjakovë një rast (81 vjeç),

Rahovec një rast (69 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 45 594 raste nga 160 352 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 174 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 696 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 32 498 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 11 922.

Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 244 raste, Mitrovicë 46 raste, Podujevë 35 raste, Fushë-Kosovë 32 raste, Gjilan 25 raste, Lipjan 25 raste, Viti 24 raste, Vushtrri 22 raste, Drenas 21 raste, Gjakovë 21 raste, Obiliq 20 raste, Ferizaj 13 raste, Prizren 13 raste, Kamenicë 10 raste, Skenderaj 6 raste, Malishevë 5 raste, Suharekë 5 raste, Kaçanik 4 raste, Pejë 4 raste, Dragash 3 raste, Rahovec 3 raste, Deçan 2 raste, Klinë 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Istog, Novobërdë, Zubin-Potok.



## Zemaj: Numri i të vdekurve nga Covid-i mbetet i lartë

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë të premten se autoritetet shëndetësore të këtij vendi kanë vërejtur stagnim të rritjes së rasteve të infektimit në javët e fundit në Kosovë. Megjithatë, ai ka thënë se respektimi i masave që janë në fuqi, duhet të vazhdojë patjetër dhe me intensitet të shtuar, meqë spitalet janë të mbingarkuara. "Në ecurinë e pandemisë është vërtetuar se numri i vdekjeve mbetet i lartë edhe disa javë pas fillimit të rënies së numrit të rasteve", ka thënë Zemaj.

Përgjatë konferencës ai ka bërë me dije se pas analizimit të situatës shëndetësore në Kosovë me koronavirus, autoritetet kanë përditësuar kategorizimin e ri të qyteteve në zona, në bazë të rrezikshmërisë së përhapjes së koronavirusit. Në zonën e kuqe janë 16 komuna, në atë të verdhë nëntë komuna, kurse në zonën e gjelbër 13 komuna. Në qytetet që janë në zonën e kuqe, nga ora 19:00 mbyllët çdo aktivitet ekonomik dhe vendoset kufizim i plotë i lëvizjes së qytatarëve si dhe

ndalohen hyrje-daljet në këto komuna deri në orën 5:00. Komunat që janë në zonën e verdhë u lejojnë operatorëve ekonomik që të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 18:00. Pas këtij orari, shërbimet e hotelerisë dhe të gastronomisë mund të punojnë me shërbimin "merre me vete" dhe "porosi me dërgesë". Në komunat e zonës së gjelbër, që hyjnë në këtë zonë me rrezik më të ulët të përhapjes së koronavirusit, operatorët ekonomikë do të lejohen të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 20:00.

## Diskutohet shtimi i bashkëpunimit në mes të Prokurorit të Shtetit dhe KFOR-it në Kosovë

Kryeprokurori Lumezi ka uruar komandantin Federici për detyrën e re, duke shprehur falënderimin dhe mirënjojen e tij për angazhimin e KFOR-it në shërbim të paqes dhe sigurisë në Republikën e Kosovës

**PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER)** - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, i shoqëruar nga kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi, ka pritur në takim njoftues komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici. Fillimisht kryeprokurori Lumezi ka uruar komandantin Federici për detyrën e re, duke shprehur falënderimin dhe mirënjojen e tij për angazhimin e KFOR-it në shërbim të paqes dhe sigurisë në Republikën e Kosovës. Po ashtu, kryeprokurori i shtetit ka njoftuar komandantin e ri të KFOR-it për funksionimin, punën, të arriturat

dhe sfidat e institucionit të Prokurorit të Shtetit në ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore në funksion të sundimit të ligjit, forcimit të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së vlerave të përbashkëta të identitetit evropian. Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi dhe komandantin e i KFOR-it, gjeneralmajor, Franco Federici, kanë vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm ndërinstitucional si dhe u pajtuan që ta shtojnë atë edhe në të ardhmen, lidhur më çështjet e interesit të përbashkët në kuadër të rolit dhe përgjegjësive institucionale.





# Përfitimet e gurëthyesve nga qeveria

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Rreth 15

KOSOVËS, 11 BIRJUER - Rreth 15 milionë euro do të ketë të hyra më pak në buxhetin e Kosovës në pesë muajt e parë të vitit tjetër, thuhet në një përgjigje nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Kjo mungesë e të hyrave do të paraqitet për shkak të lirimit nga pagesa e rentës minerare për kompanitë që merren me prodhimin e produktive të betonit, apo siç nijben me emrin gjyqtarëve.

Lirimi i pagesës së rentës minerare prej datës 1 janar deri 31 maj 2021 parashihet në Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike që është miratuar më 4 dhjetor në Kuvendin e Kosovës. Renta minerare nënkuption shumën që duhet paguar shtetit (Buxhetit të Republikës së Kosovës) si kompensim për shfrytëzimin e resurseve. Për një metër kub këto lëndë, i kohës së tij, do të kosto

paguajnë 0.50 centë.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) është organi përgjegjës për vlerësimin dhe arkëtimin e rentave minerare. Sipas këtij komisioni, në vitin 2019 janë inkasuar më shumë se 30 milionë euro taksë për rentë minerare. Kjo vlerë është realizuar nga 199 kompani sa janë të licencuara për shfrytëzim të materialeve të ndryshme ndërtimore. Nga këto kompani, 181 kanë licenca për shfrytëzim të gurit të fortë dhe 18 për shfrytëzim të rërës dhe zhavorrit.

## KPMM: Gurëthyesit gjatë kësaj periudhe mund ta “shfrytëzoinë situatën”

## Kompanit  nga burimet e licencuara nyierrin qurip i cili

më pas përpunohet dhe përdoret për ndërtim, qoftë të rrugëve apo edhe ndërtesave. Por, zyrtarë të Komisionit të Pavarur për Minerale dhe Miniera, thonë se ndërmarrjet që merren me prodhimin e këtyre produktave, gjatë kësaj periudhe mund ta shfrytëzojnë situatën duke nxjerrë më tepër material të nevojshëm, pér të siguruar pér gjithë vitin. “Ka mundësi, pasi ndërmarrjet do të përpiqen që ta rrisin aktivitetin e shfrytëzimit me qëllim që të sigurojnë lëndë minerale të gatshme pér tërë vitin 2021, madje edhe më shumë”, thuhet në një përgjigje pér “Radion Evropa e Lirë” nga KPMM-i.

"E vëtmja masë e mundshme që mund ta ndërmarrë KPMM-ja, sipes tyre është gë

në baza mujore ndërmarrjeve të mos u lejohet shfrytëzimi (minimi) më shumë se sa e kanë të paraparë në projektin e shfrytëzimit”, thuhet në përgjigje.

pergjigje. Por, pronari i fabrikës së betonit “Gurëthyesi Agi-Dani” në Gjilan, Bashkim Veseli, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se nuk kanë mundësi që të krijohen rezerva për shkak se tashmë kanë dërguar planin e shfrytëzimit bazuar në vëllimin e mineraleve të nxjerra në KPMM-ja. Ai, ndërkaq, tregon se gjatë një viti arrin të sigurojë rrëth 200 mijë kubikë gurë. “Nuk ka mundësi të krijohen rezerva. Unë i kam dy miniera dhe e llogaritëm, nëse arrijmë të shfrytëzojmë pesë muaj, nëse na lejon moti, ka mundësi të nxjerrim 50 mijë kubikë”, thotë Veseli.

## Janar-maj, periudhë e pafavorshme për gurëthyesit

Adem Kçiku, pronar i gurëthyesit “Bejta Comerc” në Gjilan, thotë se më shumë se 60 mijë euro paguan në institucionet kompetente në emër të rentës minerare. Megjithatë, ai thotë se periudha e lirimit të pagesës është e papërshtatshme për kompanitë e gurëthyesit, sepse gjatë periudhës janar-maj nuk ka shumë minime për shkak të kushteve klimatike. Kçiku, i cili disa herë ka fituar tenderë nga Qeveria e Kosovës për ndërtim të rrugëve, thotë se për kompaninë e tij, më e rëndësishme është që ekzekutivi t'i përfundojë obligimet për punët e kryera se sa lirimin nga pagesa e rentës

**Komisionit për hidrocentrale i vazhdohet mandati**

**PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) -**  
Kuvendi i Kosovës ia ka  
zgjatur mandatin  
Komisionit Parlamentar  
për Licencim Operim

Mbikëqyrje dhe Aplikim për Leje të Hidrocentraleve. Me 65 vota për, u votua zgjatja e mandatit të këtij komisioni. Po ashtu

deputetët e kanë miratuar edhe buxhetin për këtë komision që është shtatë mijë e 470 euro për tre muajt e ardhshëm, aq sa i

është zgjatur mandati komisionit. Ky miratim është bërë me iniciativën e deputetës së PDK-së, Elizabet Hoxha.



pasi thotë se edhe kompania e tij ka pasur humbje për shkak të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi. "Unë besoj se gjatë kësaj periudhe që kanë caktuar për lirim nga pagesa deri në 30 mijë euro, na lehtësojnë. Më mirë do të ishte për gjithë vitin, por edhe kjo mjafton shumë", thotë ai.

#### Murati: Klientelizëm i pastër

Por, kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës, Hekuran Murati, që vjen nga Lëvizja Vetëvendosje, shprehet se ky është paraqet "klientelizëm të pastër" dhe se për këtë arsyesh nuk është votuar në Komision, porse ka arritur të votohet në Kuvend. "Ky është klientelizëm i pastër, sepse shënjestron kompani të caktuara. Marrëdhënia këtu është klientelizëm i pastër", tha shkurt Murati për "Radion Evropa e Lirë".

Aleanca për Ardhmérinë e Kosovës ka paraqitur këtë amendament në kuadër të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Deputeti i kësaj partie, Gazmend Abrashi, tha se nuk ka lidhje me asnjë pronar të ndonjë gurthyesi dhe vlerësimin e anëtarëve të Vetëvendosjes e quan hipotetik. Arsyja e futes së këtij amendamenti në ligji, sipas Abrashit, është që të ndihmohet sektori privat për shkak të humbjeve që ka pësuar gjatë pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi. "Këtë masë që e kemi propozuar ne, fatmirësish e ka përkrahur edhe Kuvendi i Kosovës, është masë të cilën e kanë aplikuar të gjitha qeveritë e Ballkanit Perëndimor qysh para 3-4 muajsh. Duke e marrë parasysh se me rënien e kërkesës aggregate në treg ka rënë edhe çmimi, kjo ka qenë përkrahja më e vogël që kemi mundur t'i bëjmë këtij resori ekonomik me qëllim të ruajtjes së vendeve të punës", thotë ai.

"Në këtë periudhë, janar-maj, më së shumti mund të nxjerim 20 mijë kubikë, sepse është periudhë që nuk punojmë, pasi ne vetëm në mars marrim tenderë për të punuar rrugë. Çdo muaj ne bëjmë një minim mbi 10 mijë kubikë. Për këtë periudhë ne nuk mund të bëjmë më shumë se dy minime apo 23 mijë kubikë", thekson Kçiku.

Kurse Bashkim Veseli konsideron se lirimi nga pagesa e rentës minerare do të ndihmojë shumë në operimin e biznesit të tij. Ai gjatë një viti tregon se paguan deri në 70 mijë euro rentë minerare varësisht nga kërkesat për produktin.

Me shumën e falur nga qeveria, Veseli thotë se do ta ketë më lehtë mbajtjen e punëtorëve në punë, me shumë e falur nga qeveria, Veseli thotë se do ta ketë më lehtë mbajtjen e punëtorëve në punë,

# BE-ja thyen bllokadën për buxhetin dhe fondin e rimëkëmbjes

**BRUKSEL, 11 DHJETOR** - Udhëheqësit e Bashkimit Evropian kanë arritur marrëveshje për buxhetin e bllokut dhe fondin e rimëkëmbjes nga pandemia Covid-19 në vlerë prej 1.8 trillion eurosh. Marrëveshja është bërë pas një kompromisi me Hungarinë dhe Poloninë. Dy vendet kanë kërcënuar se do të vendosin veto mbi klauzolën që lidh financat me respektimin e sundimit të ligjit. Kjo do të

mund t'i kushtonte atyre miliarda euro nga BE-ja, pasi janë duke u hetuar për minimin e pavarsisë së gjykatave dhe mediave. Por, dy vendet janë siguruar se klauzola do të zbatohet vetëm për shpenzimet e ardhshme. "Tani mund ta nismi zbatimin dhe t'i rindërtojmë ekonomitë tona. Paketa jonë historike e rikuperimit do t'i çojë përparrë tranzicionet tona të gjelbra dhe digitale", ka thënë presidenti i

Këshillit Evropian, Charles Michel, pas arritjes së marrëveshjes. Në korrik, BE-ja është pajtuar në parim për buxhetin prej 1.1 trillion eurosh për periudhën 2021-2027 dhe përfundon e stimulimit prej 750 miliardë eurosh, por kjo paketë kishte nevojë përmeshtetjen unanime nga të gjithë anëtarët e bllokut. Pa marrëveshje, BE-ja do të ishte detyruar të përdorë një buxhet të kursimit përfundimtari e ardhshëm.



## Qumështarët do të subvencionohen me 25 për qind të vlerës së produkteve që kanë në stoqe

**PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER)** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur të premten në një takim drejtuesit e Shoqatës së Industrisë së Qumështit të Kosovës. Krasniqi ka bërë me dije se kanë diskutuar për problemet e tyre që janë shfaqur si pasojë e pandemisë. Ai ka treguar se do të bëhet edhe ekzekutimi i mjeteve të subvencionimit prej 25-përqindësh të vlerës së produkteve që kanë në stoqe. "Prita sot në një takim drejtuesit e Shoqatës së Industrisë së

Qumështit të Kosovës. Bashkë diskutuan për problemet e tyre që janë shfaqur si pasojë e pandemisë. I njoftova për raportin që është përgatitur nga komisioni i formuar nga MTI-ja lidhur me stoqet që prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit kanë nëpër depo. Në bazë të të dhënave që janë paraqitur në raport do të bëhet edhe ekzekutimi i mjeteve të subvencionimit prej 25-përqindësh të vlerës së produkteve që kanë në stoqe", ka thënë ministri Krasniqi.



## 78 bujq dhe fermerë në Ferizaj përfitojnë mekanizëm bujqësor


**FERIZAJ, 11 DHJETOR (ER)** - Mbështetja si asnjëherë më parë për bujqit e fermerët ferizajas po dëshmohet me subvencione të shumta nga më të ndryshmet, me qëllim lehtësimin e veprimtarisë së tyre. Së fundmi, është një kontingjent i madh i mekanizmit bujqësor që u shpërndanë për bujqit e fermerët ferizajas. 78 prej tyre janë përfitues sipas thirrjes

publike të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyltarisë. Për t'i shpërndarë ato, doli i pari i Ferizajt, Agim Aliu, i cili ishte i shoqëruar edhe nga drejtori i Bujqësisë dhe Pyltarisë, Burim Bajrami, si dhe drejtorë të tjera të komunës. I pari i bujqësisë dhe pyltarisë në Ferizaj, Burim Bajrami, ka thënë se me këtë mbështetje po investohet përvillimin e qëndrueshëm të

veprimtarisë bujqësore në Ferizaj dhe se ky ka qenë synimi i mbështetjes nga kjo drejtori, përfitues të cilave, mekanizmit bujqësor modern, janë 78 bujq dhe fermerë ferizajas. Falënderues u shprehën edhe përfituesit e mekanizmit bujqësor të cilët thanë se me këtë mbështetje puna e tyre dhe angazhimi në bujqësi lehtësitet maksimalisht.



## Për 16 ditë u mbajtën aktivitete në Malishevë me moton "Edukimi fillon me ne"



**MALISHEVË, 11 DHJETOR (ER)** - Zyrtarja për barazi gjinore, Vera Bytyçi, me bashkëpunëtore edhe të asociacioneve të tjera që veprojnë në Komunën e Malishevës, si brenda institucioneve apo edhe si

OJQ, për 16 ditë rresht organizuan aktivitete me moton "Edukimi fillon me ne", me forume të ndryshme, por edhe nëpër institucionet arsimore. Sipas njoftimit nga zyrtarja për barazi gjinore, Vera

Bytyçi, u mbajtën ligjérata dhe punëtori me të gjitha shkollat, u realizuan aktivitete të ndryshme, si ese e punime lidhur me temën në fjalë. Ndërsa në fund të aktiviteteve është vizituar strehimorja

## Obiliqi ndan 100 euro për çdo të infektuar me Covid dhe nga 300 euro për familjet e viktimate

**OBILIQ, 11 DHJETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka bërë me dije se Kuvendi Komunal ka marrë vendim t'i mbështesë me nga 100 euro qytetarët e kësaj komune që janë të infektuar me Covid-19, ndërsa familjet e viktimate me nga 300 euro. Gashi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se për formën dhe mënyrën e aplikimit, ekipet e

shtabit emergjent do t'i njoftojnë të gjithë qytetarët e prekur me Covid-19, sipas listës me testimet PCR të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. "Me këtë rast falënderoj asamblistët e Kuvendit për përkrahjen e këtij vendimi, i cili do të shërbejë si përkrahje për të gjithë qytetarët, që sadopak të kompensohen shpenzimet e bëra gjatë trajtimeve mjekësore të virusit Covid-19", ka thënë Gashi.



## Drenasi vazhdon bashkëpunimin me "Women for Women"

**Drenas, 11 dhjetor (ER)** - Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik në Drenas, Egzona Jetullahi dhe drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka, kanë pritur të premten në takim Kushtrim Shehun, koordinator i organizatës "Women for Women", me të cilin kanë biseduar përmundësinë e bashkëpunimit në kuadër të projektit "I SEE", punësimi dhe vetëpunësimi që ka për qëllim kryesor përmirësimin e grave të marginalizuara, për tekalimin e pengesave dhe përfshirjen në ekonomi dhe në tregun e punës, duke ngritur kapacitetet e tyre.

Koordinatori Shehu ka falënderuar Komunën e Drenasit për bashkëpunimin e treguar për realizimin e këtij projekti dhe i ka informuar të

pranishmit se një numër i caktuar i përfituesve kanë përfunduar trajnimin katërmujor dhe në bashkëpunim me DKA-në do t'u mundësoset edhe pjesa praktike në institucionet arsimore.

Komuna e Drenosit ka nënshkuar memorandum bashkëpunimi me OJQ "Women for Women" me të cilin ka për qëllim vetëpunësimin dhe përmirësimin e pozitës së grave në ekonomi dhe tregun e punës.

Ky projekt bazohet ka për qëllim që të ofrojë trajnime profesionale të akredituara në sektorët potencialë të punësimit në bazë të kërkesave të bëra në sesionet informuese të mbajtura paraprakisht.



## IV. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe rapporti me prapavijë politike



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Miratimi i rezolutës së lartpërmendor nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe kërkesa e Këshillit të Sigurimit të OKB-së drejtar Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, që të sqaronte nëse shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, trimëroi edhe më shumë Serbinë dhe qarqet e afërtë me të.

Prezantimi i Kosovës si "shtet mafioz" dhe i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si "Ndërmarrje Kriminale", që gjoja ka kryer shitjen e organeve njerëzore, vazhdoi me intensitet edhe më të madh gjatë gjithë kohës kur pritej që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të sillte vendim lidhur me ligjshmërinë e aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Megjithatë, në këtë rast fushata propagandistike nuk mundi të ndikojë në vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Pasi shqyrtoi të gjitha argumentet që kishin të bënin me kérkesën e shtruar në emr të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe duke u mbështetur në argumentet e trajtuar dhe të ekspozuara në 121 paragrafë të vendimit të vet, më 22 korrik 2010 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

shpalli se akti *"i miratimit të deklaratës së pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurtit 2008, nuk e ka shkelur as të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, as rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit e as Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Prandaj, miratimi i kësaj deklarate nuk ka bërë shkeljen e asnje rregulle të aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare"*.

Përkundër faktit se ishte pikërisht Serbia dhe mbështetësit e saj që kerkuan nga Gjykata Ndërkombëtare të Drejtësisë të sqaronte ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovë, vendimi i GJND-së i tërboi tërështet dhe në vend që të pranonin qëndrimin e kësaj instance juridike ndërkombëtare, ata u lëshuan në akuza nga më të rëndat kundër kësaj gjykate.

Paralelisht me këto akuza, Serbia u orientua në përpilimin e raportit që ishte kërkuar nga Komisioni për Çështjet Juridike dhe të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës. Pesë muaj pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, më 12 dhjetor 2010, i ngarkuari i komisionit të lartpërmendor, Dick Marty, në emr të vet dhe të ekipit të tij, dorëzoi projekt-raportin e titulluar "Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimin kundërligjor me organe njerëzore në Kosovë", që realisht ishte përgatitur nga Shërbimi Sekret i Serbisë. Për të mos lënë asnjë dyshim lidhur me atë se çka nënkuqtohet me fjalën "Kosovë", që në titull hartuesit e këtij rapporti e shënjojnë me yll (\*)fjalën "Kosovë" dhe bëjnë sqarimin në

fusnotë se "të gjitha referimet që kanë të bëjnë me Kosovën, qoftë territori, qofshin institucionet apo popullata e saj, duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjikuar statusin e Kosovës".

Dick Marty, për të cilin shqiptarët e Kosovës nuk janë popull të cilit i takon e drejta për vëtëvendosje, por, "shqipfolës që kishin shpallur pavarësinë në kundërshtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare";

Dick Marty, për të cilin "Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara flet në tri vende për integritetin territorial serb dhe thotë se Kosova është krahinë serbe që do të administrohej përkohësisht nga ndërkombëtarët";

Dick Marty, që deklaroi se "shumica e vendeve nuk e kanë njohur dhe nuk do ta njohin Kosovë", nuk e kishte aspak të vështirë të vente emrin e vet në një raport që shpërfaq paragjikimet për Kosovën si territor, institucione dhe popullsi nën sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë, përkundër faktit se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë saktësonte se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244.

Pas debateve që u zhvilluan në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, më 16 dhjetor 2010 u miratua projekt-rezoluta e dorëzuar në emr të Dick Martyt. Menjëherë pas miratimit të këtij rapporti, 34 deputetë të Parlamentit të Zvicrës, miq të Dick Martyt, pjesëtarë të Grupit

Unioni Demokratik i Qendrës, dorëzuan një "postulat" drejtar Këshillit Federal të Zvicrës.

Nacioni "postulat" kryesishet njihet si nacion matematikor, që konsiston në domosdoshmërinë e pranimit paraprak të një parimi si të vërtetë, pa pasur nevojë përta demonstruar vërtetësinë e tij. Në të drejtën zvicerane "postulati" është kërkesë e deputetëve drejtar Këshillit Federal, që ky institucion shtetëror të shqyrtojë mundësinë t'i dorëzojë Parlamentit të Zvicrës për miratim një ligj apo një mase të caktuar.

Kur shihet përbajtja e "postulatit" të deputetëve zviceranë, del në shesh se "postulati" i 34 deputetëve zviceranë është i ngjashëm me "postulatin" matematik! Në tekstin e këtij "postulati", deputetët nënshkrues e "informojnë" Këshillin Federal se "më 16 dhjetor 2010, Këshilli i Evropës u njofua me reportin e Dick Martyt lidhur me trafikimin e organeve në Kosovë", se

"thëniet që përban ky report lidhur me trafikimin e organeve në Kosovë janë shumë të vërteta" dhe rrjedhimisht nuk kanë nevojë të vërtetohen! Për këtë arsy, nënshkruesit e këtij "postulati" e lusin Këshillin Federal të Zvicrës:

1. Që ta rishikojë politikën e vet karshi Kosovës,  
2. Që të mendojë një politikë të re ndaj Kosovës, e cila duhet të marrë parasysh më mirë se deri tani interesat legitime të Serbisë dhe të minoritetit serb në Kosovë,  
3. Që të presë rastin e favorshëm përtë kontribuar në skenën politike ndërkombëtare në kërkim të një zgjidhjeje të re, të

drejtë dhe të pranueshme për konfliktin mes Serbisë me Kosovës".


Në argumentimin e tyre, deputetët nënshkrues të "postulatit" përsërisin akuzat që përmban rapporti në fjalë dhe sipas përpiluesve të "postulatit" "në dritën e këtij realiteti tronditës dalin në shesh dy gjëra: Së pari, kultura, qeverisja dhe praktikat e autoriteteve të Kosovës janë shumë larg nga kushtet minimale që duhet t'i plotësojë një shtet ligjor. Dhe së dyti, procesi që çoi në njohjen e diskutueshme të Kosovës pati si pasojë diskriminimin sistematik të Serbisë në krahasin me Kosovën. Këto dy elemente arsyetojnë rishikimin e politikës së Këshillit Federal ndaj Kosovës".

Këshilli Federal i Zvicrës e hodhi poshtë këtë "postulat", mirëpo momenti i dorëzimit dhe sidomos përbajtja e tij janë tregues shtesë për motivet e vërteta politike të përpilimit të këtij rapporti: rishikimi i njohjes së pavarësisë së Kosovës!

Fatkeqësish, më 7 janar 2011, rapporti ideologjik me prapavijë politike i përpiluar nga Shërbimi Sekret i Serbisë, i trafikuar me emrin e Dick Martyt, u dorëzua në formë rezolute në Asambleën Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe u miratua më 25 janar 2011. Ndërkaj, në përputhje me Rezolutën 1782 të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës, John Clint Williamson u emërua shef i TASK Forcës Speciale të EULEX-it përtë udhëhequr hetimet lidhur me pretendimet përtë tregti me organe njerëzore nga ana e UÇK-së.

(Vijon)





# Derbi në Suharekë

Sot (e shtunë) zhvillohen dy ndeshje në elitën e basketbollit, ku spikat përballja në mes të Bashkimit dhe Prishtinës, ndërsa derbi zhvillohet nesër (e diel) në mes të Golden Eagle Ylli dhe Rahovecit

**PRISHTINË, 11 DHJETOR** - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e shtatë në Prince Caffe Superligën e Kosovës në basketboll. Sfida e parë do të zhvillohet ndërmjet Vëllaznimit dhe Pejës. Skuadra kuqezi, pas fitores ndaj Sigal Prishtinës, do të tentojë ta befasojë edhe Pejën, që ka gjashtë fitore në gjashtë ndeshje deri më tanë, duke qenë skuadra e vetme pa humbje në elitë, kurse Vëllaznimi ka dy fitore dhe katër humbje.

Dueli tjetër i së shtunës është Bashkimi - Sigal Prishtina. Prizrenasit kanë një fitore dhe pesë humbje deri më tanë, kurse prishtinasit dy fitore dhe katër humbje, andaj fitorja është shumë e vlefshme në këtë përballje. Takim interesant shihet ai ndërmjet Trepçës dhe Ponte Prizrenit.



## PRINCE CAFFE SUPERLIGA - JAVA 7

**Të shtunën takohen:**  
**13:00 Vëllaznimi - Peja**  
**15:00 Bashkimi - Sigal Prishtina**

**Të dielën takohen:**  
**15:00 Trepça - Ponte Prizreni**  
**17:00 Golden Eagle Ylli - Rahoveci**

## Superliga e Femrave - Java 10

**Të shtunën takohen:**  
**16:00 Kosovahome Prishtina - Kastrioti**

**Të dielën takohen:**  
**11:30 Trepça - Penza**  
**13:00 Bashkimi - Vëllaznimi**

Mitrovicasit kanë dy fitore dhe katër humbje, kurse prizrenasit tri fitore dhe tri humbje në gjashtë duele të zhvilluara. Ndeshja kryesore e kësaj xhiro është mes Golden Eagle Yllit dhe Rahovecit. Të dyja skuadrat kanë nga katër fitore dhe dy humbje, si dhe rivaliteti mes këtyre dy skuadrave bën që përballja të jetë shumë interesante, ashtu siç ka qenë në vitet e fundit.

## Sezoni vjeshtor përballet me derbin Bashkimi - Vëllaznimi

Këtë fundjavë do të zhvillohet xhiroja e dhjetë në Superligën e Femrave, apo xhiroja e fundit për stinorin vjeshtor. Ndeshja

kryesore do të zhvillohet ndërmjet Bashkimit dhe Vëllaznimit, dy skuadra që kanë nga tetë fitore dhe një humbje. Ky duel do të përcaktojë se kush do të dimërojë në vendin e parë. Në ndeshjen e parë mes këtyre dy skuadrave në Gjakovë, fitore kishte shënuar skuadra prizrenase 66:99. Ndërkohë, Bashkimi humbjen e vetme e ka pësuar nga Kosovahome Prishtina pas katër vazhdimeve 148:144. Kosovahome Prishtina do të përballet me Kastriotin. Skuadra prishtinase ka pesë fitore dhe katër humbje, kurse ajo ferizajase ka një fitore dhe tetë humbje. Trepça që, po ashtu ka një fitore dhe tetë humbje, do të ndeshet me Penzën. Kjo e fundit mundi Prishtinën në mesjavë dhe ka katër fitore e pesë humbje.

# Besa, plot besim para ndeshjes me Boracin

**PEJË, 11 DHJETOR** - Kampionia e Kosovës, Besa Famgas, është e gatshme për ndeshjen e vështirë ndaj Boracit të Banjallukës. Besa e Boraci takohen sot (e shtunë) në palestrën "Karagaci" në Pejë nga ora 17:00, në ndeshjen e parë të raundit të tretë të Kupës Evropiane. Në raundin e dytë Besa e eliminoi Bosna Visokon. Tani sërisht përballet me skuadër nga Bosnjë-Hercegovina. Te Besa janë të vendosur për hapin tutje në skenën evropiane. Ndeshja e kthimit luhet pas një javë në Banjallukë. "Në vitin 2012 kam debutuar për Besën kundër Boracit në Banjallukë. Tani, tetë vjet më vonë, kemi një grup lojtarësh që mund të rivalizojmë çdo ekip që bën gara në European Cup. Do të jetë ndeshje shumë e fortë sepse Boraci ka një ekip shumë cilësor. Por besoj se ka ardhur koha për revansh dhe të plasohemi në mesin e 16 skuadrave më të mira në European Cup", ka thënë Kastriot Jupa, hendbollist i Besa Famgas.



Hendbollisti tjetër i skuadrës pejane, Charalampos Mallios, ka deklaruar: "Na presin dy ndeshje të forta, por synimi ynë është të jemi në mesin e 16 skuadrave më të

mira dhe do ta japim maksimumin. Kam besim në ekipin tim, pasi e di sa shumë kemi punuar deri më tanë. Në këtë nivel të Kupës Evropiane të gjitha ndeshjet janë derbi".

## SHKURT

### Ademi takohet me Challandesin, shpalosin planet për vitin 2021

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, është takuar në Cyrih të Zvicrës me përgjedhesin e Përfaqësueses A, Bernard Challandes. Sipas njofitimit të FFK-së, në këtë takim u bisedua për gjithçka që e pret Përfaqësuesen A gjatë vitit 2021, duke filluar nga shorti për ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Botëror të vitit 2022 si dhe për nivelin organizativ brenda ekipit. "Ishte konstatim i përbashkët se duhet të krijohet një plan konkret i veprimit gjatë kësaj kohe. Po ashtu u diskutua edhe për miqësoret e shumta që Kosova do t'i zhvillojë gjatë vitit 2021, por edhe për situatën aktuale të futbollistëve të Përfaqësueses nëpër klubet e tyre", thuhet në njofitimin e FFK-së. Një pjesë tjetër dhe rëndësishme ishte diskutimi për të gjitha projektet e kryetarit dhe trajnerit për konsolidimin e stafit dhe realizimin e kampeve dhe sektorëve që duhet të veprojnë.

### Përfundon sezoni vjeshtor për Boshnjakun

Sezoni aktual ka përfunduar për kapitenin e Prishtinës, Lorik Boshnjaku. Në seancën e fundit, një ditë para ndeshjes Gjilani - Prishtina, Boshnjaku pësoi një lëndim që nuk dihej shkalla e lëndimit. "Pas ekzaminimit të hollësishëm është konstatuar se ka lënduar fijen e muskulit të krahut, por fati në fatkeqësi është se nuk ka nevojë për operim. Megjithatë, kapitenit tonë i duhet të pushojë gjatë kësaj kohe dhe për të ka përfunduar stinori vjeshtor duke humbur katër ndeshjet e fundit", thuhet në njofitimin e Prishtinës. Lorik Boshnjaku në këtë edicion deri para lëndimit është paraqitur në të gjitha ndeshjet, apo 15 sa ishin zhvilluar.

## Rrahmani dhe Hysaj, të enjten pozitivë, të premten negativë

**NAPOLI, 11 DHJETOR -** Mbrojtësit e Napolit, Amir Rrahmani dhe Elseid Hysaj, kanë rezultuar negativë në testin e fundit për Covid-19. Dyshja kishin dalë pozitivë sa ishin pjesë e ndeshjeve të

kombëtareve gjatë muajit nëntor. Trajneri italian, Gennaro Gattuso, i përfshiu ata të dy në listën e skuadrës së Napolit për ndeshjen me Real Sociedadin të enjten në

kuadër të Evropa Ligës, por mbrojtësit rezultuan përsëri pozitivë para ndeshjes. Ata menjëherë iu nënshtruan një testi të ri. Këtë herë ata janë shëruar plotësisht nga virusi. "Testi i fundit i Amir

Rrahmanit dhe Elseid Hysajt është negativ", shkruan në faqen e Napolit. Mbrojtësit shqiptarë të dielën do të kenë të drejtë të luajnë në ndeshjen e radhës në Serinë A kundër Sampdorias.



## Hasi: Kosova e ka grupin më të vështirë se Shqipëria



**TIRANË, 11 DHJETOR** - Trajneri i mirënjohur Besnik Hasi ka analizuar grupin e Kosovës dhe të Shqipërisë për kualifikimet e Kampionatit Botëror Katar 2022. Ish-lojtari i Kombëtares së Shqipërisë dhe disa herë i Kosovës në takimet miqësore para pranimit në UEFA e FIFA ka thënë se grupi i Kosovës është më i vështirë se sa ai i Shqipërisë. Kosova ndodhet në grup me Spanjën, Suedinë, Greqinë dhe Gjeorgjinë, ndërsa Shqipëria me Anglinë, Poloninë, Hungarinë, Andorrën dhe San Marinon. Besniku është trajner në Al Raed të Arabisë Saudite. "Me

Spanjën, Suedinë, Greqinë dhe Gjeorgjinë, Kosova e ka edhe më të vështirë sesa Shqipëria, sepse problemi nuk është te grapi, por te pritshmëria", ka thënë Hasi në intervistën për "Panorama Sport". Kosova e humbi mundësinë të kualifikohet në evropian përmes Ligës së Kombeve, për çka për Hasin me prejardhje nga Gjakova, pritshmëritë ishin për kualifikim. Ai veçon sulmuesin e 'sardanëve' Vedat Muriqi. "Pa mungesa në Ligën e Kombeve, Kosovën e shihja të kualifikuar. Tani çdokush pret më tepër nga Kosova. Edhe ndaj meje

këtu me ekipin, nuk presin më justifikime, por duan më shumë dhe kaq. Kosova ka një sulmues (Vedad Muriqi) që Shqipërisë i mungon dhe kualitetin kryesor e ka përparrë. Janë të rinx dhe të gjithë do të rriten në lojë". Hasi është pyetur edhe nëse do të jetë pengesë ose motivim për lojtarët "dardanë" të luajnë ndaj Spanjës, Gjeorgjisë dhe Greqisë, shkaku që këto vende nuk e njohin shtetin e Kosovës. "100 për qind do të jetë motivim. Lojtarët e Kosovës e kanë motivin përvendin, sepse kanë vuajtur shumë. Kjo gjë do t'i motivojë shumë", ka shtuar Hasi.

## Vettel largohet pa titull nga Ferrari: Dështova, por s'jam i penduar

**BERLIN, 11 DHJETOR** - Gara e Çmimit të Madh të Abu Dhabi në Formula 1, që do të zhvillohet këtë fundjavë, është e fundit për pilotin gjerman Sebastian Vettel me Ferrarin. Katër herë kampioni i botës do të largohet nga "kokëkuqja" pa fituar dot titullin kampion edhe pse ardhja e tij te makina italiane pritej të kishte një fund tjetër. "Nuk jam i penduar për ato që kam bërë dhe arritur te Ferrari. Natyrish se pritshmëritë e mia, por edhe të skuadrës ishin të tjera, por nuk arritëm t'i realizonim ato. Siç e kam thënë, unë dështova, Ferrari dështoi. Mendoj se kjo është më e ndershme për t'u thënë dhe pranuar nga të gjithë", ka thënë Vettel. "Me Ferrarin kam pasur një lidhje të fortë. Edhe pse kam pasur një presion, mendoj se kjo nuk ka ndikuar në rezultat dhe nuk do ta



përdor si shfajësim. Të gjithë donim të mundnim Mercedesin, të ishim më të fortë, por nuk ia dolëm dot

mbanë. Kjo ndodhi për shumë arsy. Tani të gjithë shohim të ardhmen", ka shtuar Vettel.

## SHKURT

### Kastrati, në formacionin e javës në Ligën e Evropës

Lirim Kastrati shkëlqeu me një gol dhe një asistim në fitoren 3:1 të Dinamo Zagrebit ndaj CSKA Moscow, në ndeshjen e xhiron së gjashtë të fazës së grupeve. Ylli i Kosovës fillimisht asistoi në minutën e 41-të përgolin e Orsicit. Në minutën e 75-të Kastrati arriti edhe të regjistrohej në listën e golashënuave. Paraqitja e Kastratit është vlerësuar lart nga faqet e specializuara përvlerësimi e lojtarëve. Kastrati është vlerësuar me notë 8.7 dhe ka zënë një vend në formacionin e javës.

### Tetë raste të reja me Covid-19 në NBA

Pandemia Covid-19 vijon të krijojë panik në NBA. Pas 48 rasteve të konfirmuara pas njës së fazës përgatitore, edhe 8 raste të reja janë verifikuar në testet e fundit. NBA nuk ka bërë me dije se cilët lojtarë apo cilat skuadra janë përfshirë në këto raste pozitive, ndërkohë që në total janë kryer 541 tamponë. Të gjithë lojtarët apo personat e infektuar janë vendosur në karantinë, ndërkohë që faza përgatitore vijon normalisht. Nga java e ardhshme skuadrat mund t'i kryejnë edhe ndeshjet e para miqësore. Deri më tanë, që kur ka nisur fazë përgatitore, janë konfirmuar 56 persona pozitivë me koronavirus dhe në total janë kryer 1087 teste.

### Ramosi në verë mund të largohet nga Reali

Futbollisti i Real Madridit, Segio Ramos, mund ta largohet nga "Santagio Bernabeu" në afatin kalimtar të verës. Radio spanjolle raporton se kapiteni i Realit mund të fillojë nga janari bisedimet me klubet e tjera që interesohen për shërbimet e tij, pasi duket se nuk do të qëndrojë në klubin aktual. Ramosi është pjesë e Realit nga viti 2005, kur u transferua nga Sevilla.

### Unitedi, gati ta shesë Pogban për 55 milionë euro

Mesfushori i Kombëtares së Francës, Paul Pogba, pritet të largohet nga Manchester Unitedi që në afatin kalimtar të janarit. Mediat në ishull raportojnë se skuadra e Unitedit është e gatshme ta shesë lojtarin francez për një shumë prej 55 milionë eurosh, ani pse e kishte transferuar për një shumë të lartë prej 105 milionësh nga Juventusi në vitin 2016. Interesim për Pogban kanë shfaqur Juventusi dhe Real Madridi.

### Zidane: Atletico është favorit, por ne synojmë mbrojtjen e titullit

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, në konferencë për media para derbit me Atletico Madridin ka thënë se Atletico është favorit për të fituar La Ligën. "Ata janë shumë favoritë, natyrish. Ne i njohim ata shumë mirë, si gjithmonë", ka thënë Zidane. "Ne duam të tregojmë gjithmonë se çfarë ekipi jemi, pa menduar nëse do ta fitojmë La Ligën apo jo. Duam të fitojmë gjithmonë, sa herë që luajmë, po ashtu jemi kampionë të La Ligës vitin e kaluar dhe natyrish që duam ta mbrojmë titullin. Do të luftojmë deri në fund për këtë", ka shtuar Zidane.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES**  
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**  
**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOLBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE**  
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Nr:442/1  
Dt:11.12.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032,Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212,Ligjit për Arsimin dhe AftësiminProfesional04/L-138, Neni13dhe34,Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012(Neni4),Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018,Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

### SHPALLJE E KONKURSIT

Në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2020/2021

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një(1) mësimdhënës/e për lë nden Biznes dhe ndërmarrësi me normë të plot;	Zëvendësim

#### Detyrat dhe Përgjegjësitetë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rrugolojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitet e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'uak caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin ne fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përvèç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-sës.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës përfisitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostikoni kushtet për mësim dhe proceseve mësimore tënësive përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon nëmënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.


#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuaara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvjoes punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

#### Procedurat e konkurrimit:

Afat i konkurrimit është 15ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuaara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjitenkopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvjoren e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkosat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



## KONKURS

**Pozita e punës:** Punëtor/e i/e autolarjes ( 6 pozita )

**Kohëzgjatja e kontratës:** 4 muaj

**Orari i punës:** I plotë.

**Detyrat dhe përgjegjësitetë:**

- Bën pastrimin dhe larjen e autobusëve të TU brenda dhe jashtë, pastrimi bëhet sipas planit operativ të hartuar nga kryepunëtori.
- Pastron pjesët e brendshme të autobusëve nga mbeturinat dhe pluhuri sipas rendit kronologjik që vijnë ata në vendin e caktuar për pastrim.
- Pastrimi i autobusëve bëhet çdo ditë brenda dhe me spërkatje me ujë jashtë autobusit, ditëve të vikendit të shtuneve dhe të dielave bëhet pastrimi gjeneral i autobusëve,
- Pastrimi bëhet me kujdes që mos të dëmtohen kamerat dhe pajisjet tjera elektronike, për çdo prishje të pajisjeve elektronike të shkaktuar nga mos kujdesi gjatë larjes, mbani përgjegjësi – shpenzimet për eliminim të defektit i bartë vet punëtori-ja.
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrit të udhëheqësit, para të cilit është përgjegjës, përgjegjës për punë dhe disiplinë në punë
- Për punën e tij mbikëqyret direkt nga kryepunëtori.
- Kryen edhe punë të tjera sipas kërkësës së drejtorit të administratës.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim mund të merret në zyrat e Trafikut Urban apo përmes web-faqes së TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
  - Dëshmi mbi përvjoren e punës (nëse posedon);
  - Kopja e letërnjoftimit;
- Cdo përgjegjëstrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhencë ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëherëshëm.

**Informata të përgjithshme:**

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

**Mënyra e Aplikimit:**

Kandidati/ja, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë fizike në Zyren e Protokolit në Administratën e TU-në.

Konkursi është i hapur nga data 11.12.2020 dhe përfundon më datë 25.12.2020 në ora 16:00.

NPK " Trafiku Urban" SHA  
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë - Kosovë  
web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 (0) 45 10 11 23

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "TOI 4" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksplorimin e gurëve të fortë –Andeziteve në Murgullë, Podujevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.01.2021 në ora 10:00 në hapësirat e zyrës së kompanisë "TOI 4" Sh.p.k Pn. në Podujevë do të organizohet debat publik nga kompania "TOI 4" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksplorimin e gurëve të fortë –Andeziteve në Murgullë, Podujevë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/73446042713?pwd=WEtvctIOMSs1NUlMZGsyQVllQm5Zdz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Adil Gurgusha shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Nehat Dana shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Jeton Thaqi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
- Majlinda Kajdomqaj shpall të pavlefshme dëftesat e jl VI - IX shfmu "Pjetër Budi" Lubizhd e Hasit.
- Hysen Rama shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.L.E.J. "Hoxhë Kadri Prishtinë" Prishtinë.
- Jap banesë me qira afér 60 m<sup>2</sup>, katër III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplekt, prefero ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m<sup>2</sup>, me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj lokal më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banës me qira në Ulpianë katër parë, posedon tre shtëpierë dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në Ulpiana katër parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet përbanim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokal më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

Lumës Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumës Details

lumesdetails

Mbrrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-sé
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshepte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



An advertisement for RC Cola. At the top, the RC logo is displayed with the text 'ROYAL CROWN' above it. Below the logo is a yellow rectangular box containing the text 'ANNOUNCING THE 2017 QUALITY &amp; SALES AWARDS' in large, bold, blue capital letters. To the right of the text, there is a blue can and a dark plastic bottle of RC Cola. In the bottom left corner, there is a dark blue box containing the heading 'Quality &amp; Sales Award Recipients' in yellow, followed by the note '[Listed in alphabetical order]' and a list of award recipients from various countries.

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales